

NJOFTIM PUBLIK

PËR FSHIRJEN, SHUARJEN DHE PAGESËN E DETYRIMEVE TATIMORE NDAJ ADMINISTRATËS TATIMORE QENDRORE DHE VENDORE

Në zbatim të **Ligjit nr. 86/2025, datë 11.12.2025**, “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe të detyrimeve të pagueshme në doganë”, Bashkia Mallakastër njofton subjektet debitore se:

1. **Ligji nr. 86/2025** parashikon kushtet për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore të papaguara ndaj administratës tatimore qendrore dhe administratës tatimore vendore, për kategoritë e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.
2. Përfitimi nga ky ligj zbatohet sipas periudhave kohore të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, të përcaktuara në këtë ligj.

Përfitimet sipas periudhave:

- Falet 100% e detyrimeve tatimore të papaguara, gjobat dhe kamatëvonesat deri më datë 31.12.2014.
- Falet 50% e detyrimeve tatimore, gjobat dhe kamatëvonesat për periudhën 2015–2019, nëse detyrimet paguhen deri më datë 30.06.2026.
- Falet 25% e detyrimeve tatimore, gjobat dhe kamatëvonesat për periudhën 2015–2019, nëse detyrimet paguhen deri më datë 31.12.2026.
- Falen kamatëvonesat dhe gjobat për periudhën 2020–2024, nëse shlyhen të gjitha detyrimet deri më datë 31.12.2026.

Të gjithë subjektet dhe individët që pretendojnë përfitim nga Ligji nr. 86/2025, janë të lutur të paraqiten pranë Bashkia Mallakastër, në sportelin me një ndalesë, për t’u informuar mbi detyrimet që kanë ndaj bashkisë.